

Vendim nr. 230 datë 16.10.2024

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Fiona Papajorgji,	Kryesuese
Illir Toska,	Anëtar
Sandër Beci,	Anëtar

në datën 16.10.2024 mori në shqyrtim paraparak kërkesën nr. 31 (A) 2024 të Regjistrisë Themeltar, që i përket:

KËRKUESE: ALMITA LULA, përfaqësuar nga avokat Andrea Xhani.

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimit nr. 00-2024-1187, datë 08.02.2024 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

Konstatimi i shkeljes së afatit të arsyeshëm, shpërblimit të dëmit, përshpejtimit të procedurave në gjykimin e çështjes, si rezultat i mosgjykimit të çështjes në afat nga Gjykata e Lartë.

Konstatimi i cenimit të standardit të gjykimit në vendimin nr. 43, datë 13.02.2018 të Gjykatës së Apelit Vlorë.

Konstatimi i procesit jo të rregullt ligjor për vendimin nr. 497, datë 26.06.2008 të Zyrës Rajonale të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, qarku Fier dhe vendimit nr. 1978/3, datë 25.08.2008 të drejtorit të përgjithshëm të Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave.

BAZA LIGJORE: Nenet 42, 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); neni 6 i Konventës

Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ); ligji nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar (ligji nr. 8577/2000).

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoji relatorin e çështjes Sandër Beci, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkesja Almita Lula është trashëgimtare e trashëgimlënësit Th. M., i cili në vitin 1994 i është drejtuar Zyrës Rajonale të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave të qarkut Fier (*ZRKKP, Fier*), duke kërkuar njohjen e së drejtës së pronësisë për një sipërfaqe toke prej 520 dynmë, të ndodhur në fshatin Marinës, Fier, në emër të trashëgimlënësve të tij F.M. dhe S.M.

2. Me vendimin nr. 497, datë 26.06.2008 (*vendimi nr. 497/2008*), ZRKKP-ja, Fier ka vendosur pushimin e kërkesës, duke vlerësuar se kërkesa për njohjen e pronësisë në emër të F.M. dhe S.M nuk ishte e plotë dhe se procedura kishte qenë joaktive për më shumë se 3 muaj, ndërsa subjekti nuk kishte treguar interes për më shumë se 14 vjet, ndërkohë që ishin bërë të gjitha përpjekjet për njoftimin e tij. Ky vendim, në vijim, është marrë në shqyrtim, kryesisht, nga drejtori i përgjithshëm i Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave (*AKKP*), i cili, me vendimin nr. 1978/3, datë 25.08.2008 (*vendimi nr. 1978/3/2008*), ka vendosur: (i) shfuqizimin e vendimit nr. 497/2008 të ZRKKP-së, Fier; (ii) mosnjohjen e së drejtës së pronësisë, me argumentin se subjekti nuk kishte paraqitur dokumentacionin e nevojshëm për të provuar të drejtën e pronësisë, megjithëse ai kishte barrën e provës.

3. Kërkesja i është drejtuar gjykatës së apelit me padi përmes së cilës ka kërkuar: (i) pavlefshmërinë e vendimit nr. 497/2008 të ZRKKP-së, Fier; (ii) pavlefshmërinë absolute të vendimit nr. 1978/3/2008 të drejtorit të përgjithshëm të AKKP-së; (iii) njohjen e së drejtës së pronësisë për sipërfaqen e tokës prej 520 dynmë, të ndodhur në fshatin Marinës, Fier. Në përfundim të gjykimit, Gjykata e Apelit Vlorë, me vendimin nr. 43, datë 13.02.2018, ka vendosur rrëzimin e padisë. Kundër këtij vendimi kërkesja ka ushtruar rekurs në Gjykatën e Lartë, mbi bazën e të cilit është regjistruar çështja me nr. 11243-02383-00-2018, datë 06.09.2018.

4. Në datën 15.12.2023 kërkesja i është drejtuar Gjykatës së Lartë me kërkesë për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm dhe përshpejtimin e procedurave për gjykimin e çështjes. Në përfundim të shqyrtimit të kësaj kërkesë, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2024-1187, datë 08.02.2024, ka vendosur rrëzimin e saj.

5. Në datën 07.06.2024 (*data e shërbimit postar*), kërkesja i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me ankim kushtetues individual, sipas objektit, i cili, pasi është plotësuar sipas kërkesave të ligjit nr. 8577/2000, është regjistruar në datën 12.07.2024.

II

Pretendimet e kërkeses

6. *Kërkesja*, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se i është cenuar e drejta për proces të rregullt ligjor në drejtim të:

6.1. *Së drejtës për gjykim brenda një afati të arsyeshëm*, të garantuar nga neni 42 i Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNJ-së, pasi çështja e themelit në Gjykatën e Lartë ka mbi 6 vjet që nuk shqyrtohet. Ajo gjykatë nuk ka analizuar kriteret e vendosura nga jurisprudenca kushtetuese dhe vendimi i saj për rrëzimin e kërkesës për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm dhe përshpejtimin e gjykimin e çështjes bie ndesh me këtë jurisprudencë.

6.2. *Së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e paanshme*, pasi në përbërjen e trupit gjykues që ka shqyrtuar kërkesën për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm dhe përshpejtimin e gjykimit të çështjes ka qenë edhe gjyqtari, i cili fillimisht ishte caktuar si relator i çështjes së themelit, duke qenë kështu ai në kushtet e konfliktit të interesit.

6.3. *Standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor*, pasi në gjykimin e çështjes në themel, gjykata e apelit ka arsyetuar në shkelje të ligjit për humbjen e afatit për ngritjen e padisë, si dhe se padia është e pabazuar në ligj dhe në prova. Ajo gjykatë nuk ka vlerësuar drejt provat e paraqitura në mbështetje të padisë dhe as ka zhvilluar një hetim të plotë e të gjithanshëm, duke mos kërkuar dokumentacion tjetër ligjor. Kërkesa për njohjen e pronës është bërë sipas ligjit të vitit 1993, ndaj ajo nuk mund të rrëzohej për shkak të mosplotësimin të kërkesave të ligjit të vitit 2004. E drejta e drejtorit të përgjithshëm të AKKP-së është shfuqizuar nga Gjykata, prandaj shqyrtimi kryesisht nga ai i kërkesës për njohjen e së drejtës së pronës është antikushtetues. ZRKKP-ja, Fier dhe AKKP-ja kanë shkelur ligjin në lidhje me njoftimin e vendimit.

III

Vlerësimi i Kolegjit

A. Për legjitimimin e kërkueses

7. Çështja e legjitimitit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret kumulative të nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuarra në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale dhe mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur.

8. Kolegji vlerëson se kërkuësja, si bartëse e të drejtave dhe lirive themelore kushtetuese, legjitimohet *ratione personae*, bazuar në nenet 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, pasi është palë ndërgjyqëse në procesin gjyqësor ndaj të cilit ka ngritur pretendime në drejtim të standardit të gjykimit brenda një afati të arsyeshëm.

9. Një kriter tjetër është *shterimi i mjeteve juridike efektive*, i parashikuar nga neni 131, pika 1, shkronja “f”, i Kushtetutës dhe neni 71/a, pika 1, shkronja “a”, i ligjit nr. 8577/2000, që kërkon shfrytëzimin në rrugë normale të mjeteve juridike efektive, të cilat janë të përshtatshme, të disponueshme dhe të frytshme për një çështje konkrete. Lidhur me kërkesat për konstatimin e cenimit të së drejtës për gjykim brenda afatit të arsyeshëm, Gjykata, pas ndryshimeve që iu bënë Kodin e Procedurës Civile (KPC) me ligjin nr. 38/2017, ka mbajtur qëndrimin se legjislacioni i brendshëm parashikon mjete juridike efektive që i ofrojnë individit rezultate konkrete për rivendosjen e kësaj të drejte kushtetuese. Në këtë kuptim, individi duhet t’u drejtohet gjykatave të zakonshme, në përputhje me parashikimet e KPC-së, dhe vetëm pasi të ketë shteruar garancitë e mbrojtjes që i ofrohen nga juridiksioni i zakonshëm gjyqësor, ai mund të vërë në lëvizje gjykimin kushtetues (*shih vendimet nr. 68, datë 07.12.2023; nr. 46, datë 03.10.2023; nr. 44, datë 26.09.2023 të Gjykatës Kushtetuese*).

10. Kërkuësja i është drejtuar Gjykatës me ankim kushtetues individual, duke ngritur pretendime për cenimin e së drejtës për proces të rregull ligjor, qoftë për sa i përket procedurës për shqyrtimin e kërkesës për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm, ashtu edhe për procedurën e gjykimit të çështjes së themelit nga gjykata e apelit.

11. Në lidhje me pretendimet për procesin në gjykatën e apelit për themelin e çështjes, në kushtet kur çështja vijon të jetë ende në proces në Gjykatën e Lartë, Kolegji vëren se kërkesja nuk ka shteruar mjetet juridike efektive në dispozicion, ndaj ato pretendime nuk mund të merren në shqyrtim.

12. Për sa u përket pretendimeve në lidhje me procedurën e shqyrtimit të kërkesës për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm, Kolegji konstaton se kërkesja i është drejtuar Gjykatës së Lartë në përputhje me nenet 399/1 e vijues të KPC-së, ndërsa Kolegji Penal i asaj gjykate, me vendimin nr. 00-2024-1187, datë 08.02.2024 ka vendosur rrëzimin e kërkesës. Për rrjedhojë, në lidhje me pretendimet për këtë procedurë, Kolegji vlerëson se kërkesja ka shteruar mjetet juridike efektive në dispozicion, pasi i vetmi mjet për rivendosjen e së drejtës së pretenduar të cenuar është ankimi kushtetues individual.

13. Lidhur me legjitimitimin *ratione temporis*, neni 71/a, pika 1, shkronja “b”, i ligjit nr. 8577/2000 ka parashikuar afatin ligjor 4-mujor nga konstatimi i cenimit për paraqitjen e ankimit kushtetues individual. Vendimi i kundërshtuar i Gjykatës së Lartë mban datën 08.02.2024, ndërsa kërkesa është paraqitur në Gjykatë në datën 07.06.2024, për rrjedhojë Kolegji vlerëson se është paraqitur brenda afatit ligjor 4-mujor.

14. Për sa i takon legjitimitimit *ratione materiae*, kërkesja ka pretenduar cenimin e së drejtës për t’u gjykuar nga një gjykatë e paanshme dhe së drejtës për t’u gjykuar brenda një afati të arsyeshëm.

15. Për cenimin e së drejtës për t’u gjykuar nga një gjykatë e paanshme, kërkesja ka pretenduar se në përbërjen e trupit gjykues që ka shqyrtuar kërkesën për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm dhe përshpejtimin e gjykimit të çështjes ka qenë edhe gjyqtari, i cili fillimisht ishte caktuar si relator i çështjes së themelit, duke qenë kështu ai në kushtet e konfliktit të interesit. Kolegji vëren se kërkesja nuk ka parashtruar argumente në nivel kushtetues, për të provuar se pjesëmarrja në trupin gjykues e gjyqtarit të caktuar si relator, në vitin 2018, për çështjen e themelit, i ka cenuar asaj të drejtën për t’u gjykuar nga një gjykatë e paanshme, ndërsa nuk tregohet ndonjë veprim ose mosveprim i tij që mund të klasifikohet si i kryer në kushtet e konfliktit të interesit, sikurse kërkesja pretendon. Për rrjedhojë, ky pretendim nuk mund të merret në shqyrtim.

16. Për sa i përket pretendimit për cenimin e së drejtës për t’u gjykuar brenda një afati të arsyeshëm, në kuptim të neneve 42 dhe 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës, Kolegji vëren se ai bën pjesë në juridiksionin kushtetues, ndaj do të analizohet në vijim.

B. Për shqyrtimin e çështjes brenda një afati të arsyeshëm

17. Kërkuesja ka pretenduar se çështja e themelit në Gjykatën e Lartë ka mbi 6 vjet që nuk shqyrtohet. Ajo gjykatë nuk ka analizuar kriteret e vendosura nga jurisprudenca kushtetuese dhe vendimi i saj për rrëzimin e kërkesës për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm dhe përshpejtimin e gjykimin e çështjes bie ndesh me këtë jurisprudencë.

18. Neni 42 i Kushtetutës parashikon, ndër të tjera, se kushdo për mbrojtjen e të drejtave, lirive dhe interesave të tij kushtetues dhe ligjorë ose në rastin e akuzave të ngritura kundër tij, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë dhe publik brenda një afati të arsyeshëm. Në jurisprudencën e saj Gjykata ka vlerësuar se kohëzgjatja e gjykimit, normalisht, llogaritet nga momenti i fillimit të procesit gjyqësor deri në dhënien e vendimit dhe se në kohëzgjatjen e përgjithshme të gjykimit nuk përjashtohen vonesat e shkaktuara nga zbatimi i reformës në drejtësi, pasi barra e këtyre vonesave nuk duhet të zhvendoset te palët ndërgjyqëse (*shih vendimet nr. 46, datë 03.10.2023; nr. 6, datë 16.02.2023; nr. 13, datë 26.05.2022 të Gjykatës Kushtetuese*).

19. Sipas nenit 399/2, pika 1, shkronja “b”, të KPC-së, përbën afat të arsyeshëm përfundimi i gjykimit civil në Gjykatën e Lartë brenda 2 vjetëve. Kjo do të thotë se gjykimi i çështjes konkrete në Gjykatën e Lartë është tejzgjatur, ndaj për të vlerësuar arsyeshmërinë e kësaj kohëzgjatjeje dhe për të arritur në përfundimin nëse kërkueses i është cenuar e drejta kushtetuese për proces të rregullt në këtë aspekt, duke analizuar rrethanat e veçanta të çështjes konkrete dhe kriteret e vendosura nga jurisprudenca kushtetuese që lidhen me: (i) sjelljen e kërkueses; (ii) kompleksitetin e çështjes; (iii) sjelljen e autoriteteve; (iv) rëndësinë e asaj çfarë rrezikon kërkuesja (*shih vendimet nr. 46, datë 03.10.2023; nr. 6, datë 16.02.2023; nr. 13, datë 26.05.2022 të Gjykatës Kushtetuese*).

20. Në lidhje me *sjelljen e kërkueses*, konstatohet se ajo i është drejtuar Gjykatës së Lartë me rekurs, i cili është regjistruar në datën 06.09.2018. Në datën 15.12.2023 kërkuesja i është drejtuar Gjykatës së Lartë me kërkesë për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm dhe përshpejtimin e procedurave. Kjo kërkesë është rrëzuar nga Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë me vendimin nr. 00-2024-1187, datë 08.02.2024 dhe sërish çështja ka mbetur në pritje të planifikimit për një datë shqyrtimi. Kërkuesja, pasi është njohur me vendimin e Gjykatës së Lartë, ka paraqitur ankim kushtetues individual, sipas objektit. Për rrjedhojë, Kolegji vlerëson se kërkuesja ka vepruar në përputhje me të drejtat e saj procedurale dhe nuk rezulton të jetë bërë shkak ose të ketë shkaktuar vonesa në gjykimin e çështjes.

21. Për sa i takon *kompleksitetin të çështjes*, Kolegji vëren se çështja ka natyrë civile, ndërsa kërkuesja me padinë e saj ka kërkuar: (i) pavlefshmërinë e vendimit nr. 497/2008 të ZRKKP-së, Fier; (ii) pavlefshmërinë absolute të vendimit nr.1978/3/2008 të drejtorit të

përgjithshëm të AKKP-së; (iii) njohjen e së drejtës së pronësisë për sipërfaqen e tokës prej 520 dynmë, të ndodhur në fshatin Marinës, Fier. Gjykata e Apelit Vlorë ka vendosur rrëzimin e padisë me argumentet se: (i) padia është paraqitur jashtë afatit ligjor 30-ditor për kundërshtimin në rrugë gjyqësore të vendimit të AKKP-së; (ii) padia është e pabazuar në prova dhe ligj, ndërsa kërkesja nuk ka provuar të drejtën e pretenduar të pronësisë me dokumentacion ligjor dhe hartografik. Duke iu referuar rrethanave, Kolegji çmon se çështja e kërkeses paraqitet deri diku komplekse.

22. Për sa i përket *sjelljes së autoriteteve*, Kolegji konstaton se çështja e kërkeses është në pritje për shqyrtim në Gjykatën e Lartë tashmë prej 6 vjetësh, ndërsa kohëzgjatja totale e procedurave, që prej paraqitjes së padisë në gjykatën e apelit në datën 03.04.2017, afërsisht është 7 vjet e 7 muaj. Referuar të dhënave publike për çështjet e regjistruara në Gjykatën e Lartë, sikundër edhe të dhënave në lidhje me ngarkesën e gjyqtarit relator të çështjes, Kolegji vlerëson se kohëzgjatja e gjykimit të çështjes së kërkeses në Gjykatën e Lartë lidhet me ngarkesën e lartë të asaj gjykate dhe të vetë gjyqtarit relator.

23. Së fundmi, në lidhje me *rëndësinë e asaj çfarë rrezikon kërkesja*, Gjykata ka vlerësuar se disa kategori çështjesh, për shkak të natyrës së tyre, kërkojnë përsheptim të posaçëm të gjykimit, nisur nga interesi veçanërisht i lartë i kërkesit. Disa çështje që lidhen me interesa “vetjakë e jetësorë” nevojitet të trajtohen me shpejtësi e përparësi. Të tilla janë çështjet që kërkojnë “kujdes të veçantë” ose “kujdes të jashtëzakonshëm”, si ato që lidhen me statusin civil, kujdestarinë e fëmijëve, marrëdhëniet e punësimit, sëmundjet e pashërueshme, pensionin. Lista e këtyre çështjeve nuk mund të jetë shteruese dhe kriteri i interesit të kërkesit në proces verifikohet nga Gjykata rast pas rasti (*shih vendimet nr. 43, datë 04.06.2024; nr. 21, datë 04.04.2024, nr. 6, datë 16.02.2023 të Gjykatës Kushtetuese*).

24. Në rastin në shqyrtim, Kolegji vëren se në kërkesën e saj kërkesja nuk ka parashtruar ndonjë argument në drejtim të asaj që rrezikon nga kohëzgjatja e procedurave gjyqësore. Nga ana tjetër, çështja e kërkeses, në thelb, ka të bëjë me të drejtën e pronësisë, e drejtë kjo që, sipas saj, i është hequr padrejtësisht nga shteti, pas datës 29.11.1944, ndërsa legjislati në këtë fushë garanton njohjen e saj dhe kthimin e pronës. Në këtë çështje, gjykata e apelit ka vendosur rrëzimin e padisë, duke e gjetur atë të pabazuar në themel, vendim me të cilin kërkesja nuk është pajtuar, duke paraqitur rekurs.

25. Kolegji vëren se kërkesja nuk ka arritur të provojë se çështja e saj është e një natyre të tillë që lidhet me interesa *vetjakë e jetësorë* dhe që për këtë arsye interesi i saj rrezikohet në shkallë të konsiderueshme nga kohëzgjatja e procedurave gjyqësore. Në këto kushte, në lidhje me rëndësinë e asaj çfarë rrezikon kërkesja për shkak të vonësës së Gjykatës

së Lartë në shqyrtimin e çështjes së saj, Kolegji vlerëson se ajo nuk ka argumentuar dhe provuar rrezikun për interesat e saj, natyra dhe rëndësia e të cilave të justifikojë trajtimin me përparësi dhe shpejtësi të veçantë të çështjes së saj.

26. Nisur nga sa më sipër, duke vlerësuar së bashku përfundimet e analizës të secilit prej standardeve të lartpërmendura kushtetuese, Kolegji çmon se, në rrethanat e rastit konkret, pavarësisht se formalisht afatet ligjore nuk janë respektuar, kohëzgjatja e shqyrtimit të çështjes së kërkueses në Gjykatën e Lartë në raport me situatën aktuale të ngarkesës në gjykatat e juridiksionit të zakonshëm, si dhe me rëndësinë e asaj çfarë rrezikon kërkuësja, nuk duket të ketë tejkaluar një kufi kohor të arsyeshëm në aspektin kushtetues.

27. Në përfundim, Kolegji vlerëson se kërkesa nuk përmbush kriteret paraprake, për rrjedhojë nuk mund të kalojë për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pika 2, shkronjat “d” dhe “e”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.